1151
8.9.2014

**Republika e Shqiperise**
**Qarku Kukes**
**Komuna Lekbibaj**

---

Nr. ____prot. Lekbibaj, me 20/08/ 2014

**Drejtuar:** Keshillit te Qarkut Kukes

**LENDA:** Propozim per miratimin e shpalljes se Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur", komuna Lekbibaj

Te nderuar,

Në mbështetje të Nenit 5 të Ligjit Nr. 9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8906, date 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", VKM nr. 519, datë 30.06.2010 "Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale" dhe Nenit 11 të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ju paraqesim per miratim proceduren e shpalljes se Parkut Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur;

a. Vendimi i shpalljes së Parkut Natyror Rajonal nga keshilli i komunes;
b. propozimi i miratimit te shpalljes se parkut nga Keshilli i Qarkut Kukes;
c. studimi përkatës te kryer per vlerat e parkut;
d. hartat me nënzonat e kufijtë e tyre;
e. plani i menaxhimit te parkut;
f. rregullorja e parkut;
g. administrata e ruajtjes dhe e menaxhimit te parkut.

Territori i Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur" shtrihet ne komunen Lekbibaj.
Mendojmë se miratimi i Parkut Natyror Rajonal i hap rrugë zbatimit të projekteve të tjera që lidhen me menaxhimin dhe administrimin e parkut, ngritjen dhe fuqizimin e strukturave menaxhuese, por edhe me aktivitete të tjera për promovimin e kesaj zone të mbrojtur.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

**Gezim Meshi**

**KRYETAR**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - KOMUNA - LEKBIBAJ